



Nr.04/2018 Prot
Prill 2018

Shkodër, më 11

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor:

Emri Acli Ipsia në Shqipëri
Adresa Rruga "Palokë Kurti", Nr.1, Shkodër
Tel/Fax : +355(0)68 4072096
E-mail acliscutari@gmail.com

- 1) Acli Ipsia në Shqipëri - Autoriteti Kontraktor do të zhvillojë procedurën e prokurimit me fond limit Fondi limit: 648,000.00 (gjashtë qind e dyzet e tetë mijë) Lekë me TVSH, me objekt: "Hartimi i projektit dhe i dokumentacionit përkatës" për Shtëpinë Familje.

Të dhënat e kontratës:

- 2) Lloji i procedurës së prokurimit: "Procedura e hapur".
- 3) Objekti i kontratës: "Hartimi i projektit dhe i dokumentacionit përkatës" për Shtëpinë Familje".
- 4) Fondi limit: 648,000.00 (gjashtëe dyzet e tetë mijë) Lekë me TVSH
- 5) Burimi i financimit: Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS)
- 6) Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Afati i realizimit të shërbimit do të jetë brenda 30 ditë kalendarike nga momenti i lidhjes së kontratës me objekt "Hartimi i projektit dhe i dokumentacionit përkatës" për Shtëpinë Familje".
- 7) Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje (jo me pak se 15 dite kalendarike): Data 26.04.2018, ora 10:00, vendi: Acli Ipsia në Shqipëri, Rruga "Paloke Kurti", Nr.1, Shkodër.
- 8) Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje (jo me pak se 15 dite kalendarike): Data 26.04.2018, ora 10:00, vendi: Acli Ipsia në Shqipëri, Rruga "Paloke Kurti", Nr.1, Shkodër.

Operatorët e interesuar për t'iu përgjigjur ftesës për ofertë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor :

1. Dokumentacionin e kerkuar ne DST dhe Termat e references qe i bashkengjiten kesaj ftese.

Kërkesa të tjera:

- 1) Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor brenda 24 orëve nga njoftimi i klasifikimit.
- 2) Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Për Autoritetin Kontraktor
Acli Ipsia në Shqipëri
Kordinator per Ballkanin



Daniele Socciarelli

TERMA REFERENCE

STUDIM PROJEKTIM PËR HARTIMIN E PROJEKTIT PËR OBJEKTIN “SHTËPI FAMILJE”

Projekti “Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës” AID 10950”, i bashkëfinancuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS), si dhe i implementuar nga “Istituto Pace Sviluppo Innovazione ACLI”.

1. TË DHËNA DHE KËRKESA TË PËRGJITHËSHME

REALIZIMI I PROJEKTIT

1. Objektivat

Objektivi kryesor i këtij projekti është të projektohet një godinë dy kateshe sipas normave evropiane për shtëpите familje.

Donatori ka për mision krijimin e kushteve për banim për 8 personave plus 2 persona për raste emergjente, në total 10 persona.

Kostoja e përafërt e vlerësuar në terma të përgjithshme do të konsultohet paraprakisht me operatorin e perzgjedhur .

Bashkia e Shkodrës ka në pronësi pasurinë me nr. 5/250 e ndodhur në zonën kadastrale 8593, me sipërfaqe 3350 m², nga të cilat 780 m² janë sipërfaqe ndertimore, në rrugën “Marin Becikemi”, në lagjen nr 3.

Është dakortësuar që sipërfaqja e truallit ku do të zhvillohet objekti është 822.2 m² mbi të cilin është e mundur të ndërtohet një objekt me 2 kate. Sipërfaqja është katrore.

Të konceptohet realizimi i një ndërtese multifunksionale që t’iu përgjigjet, normave dhe standardeve vendase dhe evropiane për siguri strukturore dhe funksionim të mirë të saj kundrejt kërkesave funksionale.

Objektivat parësorë të projektit përmbledhen në pikat e mëposhtme:

1. Analiza dhe vlerësimi i pozicionit të truallit dhe zonës ku do të ndërtohet, referuar përvendore.
2. Projektimi strukturor dhe arkitektonik në përputhje me kërkesat e shtruar në këtë detyrë projektimi.
3. Objekti që do projektohet i lartë, 2 kate mbi tokë.

Objektiv dytësor i projektit është:

1. Hartimi i projekteve të shërbimeve të tjera mbështetëse (arkitekturore, të instalimeve hidrosanitare, furnizimit pa ndërprerje me energji elektrike, ujë, mbrojtjes kundër zjarrit, etj), mbikëqyrjes e klimatizimit në përputhje me normat bashkëkohore të projektimit.

1.1. Qëllimi

Qëllimi kryesor është vlerësimi teknik dhe funksional i zonës që do të ndërtohet dhe marrja e masave të nevojshme inxhinierike për plotësimin e normave dhe standardeve vendase dhe evropiane për siguri strukturore dhe mirëfunksionim të tyre. Krahas qëllimit kryesor synohet përgatitja e një metodologjie e cila duhet ndjekur në përmbushjen e kërkesave të caktuara nga kjo detyrë projektimi.

1.2. Standardet

• Standardet në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe kufizimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuara. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

Projektuesi duhet të marrë parasysh, që në projektin e zbatimit të parashikojë materiale dhe sisteme, që janë të pajisura me Çertifikata Evropiane të sistemeve dhe deklarata konformiteti.

• Efiçenca e energjisë

Projekti duhet të parashikojë marrjen e masave teknike për të arritur koeficient sipas normave EU për shkëmbimin e energjisë. Për muret perimetrale (të jashtme) $U < 0.6 \text{ w/m}^2$ dhe për vetratat, profili i vetrates $U_f < 1.5 \text{ w/m}^2$ dhe xhamat $U_w < 1.4 \text{ w/m}^2$. Projektuesi duhet të marrë parasysh, që në projektin e zbatimit të parashikojë materiale dhe sisteme, që janë të pajisura me certifikata Evropiane për energjinë dhe deklaratat e konformitetit.

Arritja e këtij koeficienti mund të realizohet me aplikimin e fasadave termike, pra fasada të ventiluara, kapota termike, përdorimin e materialeve termoizoluese, etj. Ndërsa për vetratat e

jashtme duhet, që projekti të specifikojë detajin e profilit, që mundëson arritjen e koeficientit të mësipërm.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Projekti duhet të respektojë normat kombëtare dhe Evropiane për mbrojtjen kundra zjarrit përsa i përket rrugëve të shpëtimit, hapësirave të izoluar nga tymi, dyerve të zjarrit që izolojnë hapësirat nga tymi, koeficientet e zjarr durueshmërisë së dyerve dhe mureve për $E_l = 60$ min zjarr, detajet e hapjes antipanic, etj. Sistemet e përdorura duhet të jenë të pajisura me certifikatat përkatëse për mbrojtjen kundra zjarrit. Impianti i mbrojtjes ndaj zjarrit, projektimi, instalimi dhe vënia në kushte pune i rrjetit hidraulik nën presion, që duhet të furnizojë me ujë hidrantë, naspo, apo sprinkler duhet të jenë konform normës evropiane UNI9490 dhe UNI 10779, nga niveli i ngarkesës së zjarrit të parashikuar (i limituar, i moderuar apo rritës) merren në konsiderate tre zona dhe planifikohen në bazë të normativës UN 19489 si Zona e Klasit A, Zona e Klasit B, dhe Zona e Klasit C. Për objektin dhe karakteristikat e tij të shfrytëzimit impianti duhet projektuar me hidrantë statik të normës UNI45, dhe bombola me pluhur.

- **Ngrohja dhe ventilimi**

Impiantet mekanike në godinë duhet të përzgjidhen në bazë të kërkesave më të larta të kursimit të energjisë, duke përdorur tipologji të përshtatshme për ambientet dhe destinacionin e tyre për realizimin e ngrohje ftohjes kondicionimin dhe furnizimin me ajër të freskët.

Për mjediset e objektit duhet të sigurohen temperaturat Dimër/Verë $20^{\circ}\text{C}/25^{\circ}\text{C} \pm 1^{\circ}\text{C}$, lagështia $30\%/50\% \pm 5\%$ si dhe ajër të freskët deri në $50\text{m}^3/\text{h}$ për person. Impianti i kondicionimit në zonën e palestrës duhet të realizohet nëpërmjet njësisë së trajtimit të ajrit (AHU, Air Handling Unit) e cila është kërkesë taksative që ka tipologjia e ambientit trajtim 100% me ajër.

- **Ambientet sanitare**

Impianti i furnizimit me ujë të ftohtë sanitar duhet projektuar sipas kërkesave më të larta, duhet të garantohet një rezerve ujore për rastet e mungesës së furnizimit nga rrjeti i qytetit dhe duhet siguruar një sasi uji 80 litër/person.

Prodhimi i ujit të ngrohtë sanitar duhet të realizohet me pompë nxehtësie për të marrë ujin e ngrohtë sanitar me minimumin e konsumit energjetik. Akumulimi i ujit të ngrohtë duhet të ruaje ujin me temperaturë 65°C për të mos lejuar krijimin e bakteve dhe legjionelës. Duhet të ketë

edhe një rezistencë elektrike e cila do të jete e kontrolluar manualisht. Linja e riqarkullimit duhet të mbajë linjat me ujë të ngrohtë sanitar dhe programohet, që në një orar të ditës të bëjë edhe ngordhjen e mikroorganizmave dhe legioneles. Bazuar në standardet evropiane qendrat sportive duhet të furnizohen me 50 deri 60 litër/person me temperature të ujit të ngrohtë sanitar 40°C. Pajisjet hidrosanitare duhet të jenë të tipit të varur (sospeso) për të maksimalizuar higjienën në nyjet sanitare të objektit.

- **Sistemi elektrik i ndriçimit, i kontrollit të hyrjes, i video-vëzhgimit dhe sistemin rrufepritës dhe tokëzues**

Projekti elektrik duhet të marrë parasysh aplikimin e teknologjive më të përparuara për të arritur konsum minimal të energjisë, veçanërisht për ndriçimin, sistemin BMS (building management system) të paktën për administrimin e sistemit të ndriçimit dhe sistemeve mekanike për hapësirat e përbashkëta, sistemin e kontrollit të hyrjes (access control-it), sistemi i video-vëzhgimit, impiantin data dhe telefoni, impiantin TV - Sat dhe sistemin rrufepritës dhe tokëzues.

- **Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të merren parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

1.3. Rekomandime për Projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me objektin.
- Të kryejë mbledhjen e çdo të dhëne apo informacioni teknik, të cilin e konsideron të nevojshëm për realizimin e objektivave dhe qëllimit të kësaj detyre projektimi.
- Të kryejë përpunimin e të dhënave të mbledhura, duke bërë krahasimet me të dhënat e disponueshme nga studime të mëparshme dhe nga projektet ekzistuese.
- Të hartojë një strategji për implementimit të projektit.
- Në përputhje dhe në varësi të projektit strukturor, Konsulenti duhet të hartojë projektet shoqëruese arkitekturore, të instalimeve hidrosanitare, të mbrojtjes ndaj zjarrit, të instalimeve mekanike, të instalimeve elektrike, preventivin përfundimtar.

- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.
- Të realizojë projektimin duke pas kontakte të vazhdueshme me stafin e Inspektoratit Qendror.

3. Shërbimet e kërkuara

Konsulenti duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

- Analiza e detyrës së projektimit, mbledhja e të dhënave, përcaktimi i bazës së projektit.
- Analiza, modelimi kompjuterik dhe vlerësimi strukturor i ndërtesës.
- Projekt – ideja paraprake.
- Projekt – ideja përfundimtare.
- Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.
- Projekti i zbatimit.
- Preventivi përfundimtar.

3.1 Dokumentacioni teknik

Konsulenti, në përputhje me shërbimet e kërkuara, për objektin që kërkohet të ndërtohet, duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin teknik të mëposhtëm.

3.1.1 Analiza e detyrës së projektimit, mbledhja e të dhënave, përcaktimi i bazës së projektit.

Për këtë fazë të punës konsulenti duhet të paraqesë:

- Raportet e studimit gjeologjiko – inxhinierike të truallit.
- Raportet e studimit sizmologjik, nëse janë kryer.
- Përshkrimin e gjendjes së zonës ku do të ndërtohet.

3.1.2 Analiza, modelimi kompjuterik dhe vlerësimi strukturor i ndërtesës

Për këtë fazë të punës Konsulenti duhet të paraqesë:

- Raportin e detajuar të vlerësimit strukturor të ndërtesës. Në këtë raport duhet të pasqyrohen të gjitha të dhënat e përdorura, normativat ku është bazuar vlerësimi, rezultatet, interpretimet e tyre, konkluzione, rekomandime, etj.

3.1.3 Projekt – ideja paraprake

Për këtë fazë të punës, Konsulenti duhet të paraqesë:

- Të paktën dy variante paraprake dhe konceptuale të objektit, mënyrën e realizimit të tij, si edhe një kosto shumë të përafërt të punimeve, për secilin nga variantet e parashikuar.
- Vizatimet në fletët e projektit duhet të jenë konceptuale.
- Raportin me shpjegimet që lidhen me projekt – idenë paraprake.

3.1.4 Projekt – ideja përfundimtare

Për këtë fazë të punës, Konsulenti duhet të përgatisë projekt – idenë përfundimtare, ku do të përfshihen:

- Rilevimi gjeometrik dhe arkitektonik i gjendjes ekzistuese të ndërtesës.
- Projekt – idenë, e të paktën dy varianteve.
- Projektet – idetë përfundimtare shoqëruese.
- Projekt – idenë përfundimtare arkitekturore, të instalimeve hidrosanitare, mekanike, elektrike, mbrojtjes kundër zjarrit, etj.
- Projekt – ideja duhet të përfshijë vizatimet kryesore në një shkallë të lexueshme.
- Raportin me shpjegimet që lidhen me projekt – idenë përfundimtare.
- Të përgatisë një preventiv fillestar, në përputhje me fazën e projektimit, për çdo variant të paraqitur.

3.1.5 Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

Për këtë fazë të punës, Konsulenti duhet të përgatisë dokumentacionin teknik përkatës, në përputhje me kërkesat ligjore, me qëllim plotësimin e dosjes dhe marrjen e lejes së ndërtimit, nga ana e Autoritetit Kontraktor.

3.1.6 Projekti i zbatimit

Për këtë fazë të punës, për variantin fitues të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, Konsulenti duhet të përgatisë projektin e zbatimit, ku do të përfshihen:

- Projekti arkitekturor.
- Projekti i strukturës (konstruktiv).
- Projekti elektrik.
- Projekti klimatizimit.
- Projekti mekanik.

- Projekti hidrosanitar.
- Projekti i impianteve kundër zjarrit.
- Grafiku i punimeve.
- Specifikimet teknike.
- Raporti i llogaritjeve të strukturës.
- Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3.1.7 Projekti arkitekturor i zbatimit

Projekti arkitekturor i zbatimit duhet të përfshijë:

- Paraqitja e gjendjes ekzistuese.
- Planimetritë.
- Prerjet.
- Planimetria e kullimit të ujrave.
- Detaje teknike.
- Detajet artistiko – arkitektonike.
- Fotomontazh.
- Animacion.
- Relacion shpjegues i projektit arkitekturor.
- Etj.

3.1.8 Projekti strukturor (konstruktiv) i zbatimit

Projekti strukturor i zbatimit duhet të përfshijë:

- Paraqitja e gjendjes ekzistuese.
- Planimetritë.
- Prerjet.
- Detaje strukturore, nyje, hollësi, pamje, etj.
- Tabelat e specifikimit të materialeve (beton, çelik, profile, etj.).
- Etj.

3.1.9 Projekti elektrik i zbatimit

Projekti elektrik i zbatimit duhet të përfshijë:

- Planet e instalimeve elektrike.
- Ndriçimi.

- Planet e instalimeve të fuqisë.
- Llogaritjet dhe skemat e paneleve elektrike.
- Relacion i instalimeve elektrike.

3.2 Projekti mekanik i zbatimit

Projekti mekanik i zbatimit duhet të përfshijë:

- Planimetritë e instalimeve të kondicionimit, ventilimit, etj.
- Relacion i instalimeve mekanike.

3.2.1 Projekti hidrosanitar i zbatimit

Projekti hidrosanitar i zbatimit duhet të përfshijë:

- Instalimet hidrosanitare.
- Relacion i instalimeve hidrosanitare.

3.2.2 Projekti i impianteve kundër zjarrit

Projekti i impianteve kundër zjarrit i zbatimit duhet të përfshijë:

- Instalimet e impianteve kundër zjarrit.
- Relacion i impianteve kundër zjarrit.

3.2.3 Motor Gjenerator

- Në projektin e propozuar duhet ti jepet një rëndësi e vecante sitemit elektrik, furnizimit pa ndërprerje në rast avarie të sistemit duke vendosur Motor Gjenerator të fuqisë së nevojshme.

3.2.4 Dhoma e serverave sistemet e alarmit, kamera sigurie, etj

Projekti duhet të përfshijë:

- Instalimet e impiantit të dhomës së serverëve dhe të shërbimeve që lidhen me të.
- Relacion i impianteve të dhomës së serverëve, kamerave të sigurisë, sistemet e alarmit etj.

3.2.5 Panelet Elektrike

Projekti i Paneleve elektrike i zbatimit duhet të përfshijë:

- Instalimet e panelit elektrik.
- Relacion i impiantit shpërndarës të panelit.

3.2.6 Grafiku i punimeve

Konsulenti, në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur duhet të paraqesë edhe grafikun përkatës të punimeve.

3.2.7 Specifikimet teknike

Konsulenti duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren.

3.2.8 Raporti i llogaritjeve të strukturës

Konsulenti duhet të përgatisë një raport shumë të detajuar të llogaritjeve të strukturës.

3.2.9 Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis

Konsulenti duhet të përgatisë një raport të detajuar në lidhje me ndikimin në mjedis të punimeve dhe ndërhyrjeve strukturore të parashikuara në projekt.

3.3 Raporti Përfundimtar i studimit topografik

Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj të zbatimit të punimeve. Studimi duhet të përmbajë informacion për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe strukturat e drenazheve.

Për të kryerurvejimin topografik, kontraktori do të përdorë Total Station, GPS ose pajisje të ngjashme me të në teknikë dhe procedura, të cilat zhvillohen në kompjuter, në bazë të modelimit topografik të terrenit.

3.3.1 Raporti Përfundimtar i studimit gjeoteknik dhe investigimit të materialeve

Kontraktori në përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të përgatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt-idesë pranë Autoritetit Kontraktues.

Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- a. *Tekstin e raportit, parametrat gjeoteknike të projektimit.*
- b. *Materialin grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyre të veçantë të shpimeve.*
- c. *Cilësitë fiziko-mekanike të dherave dhe të shtresave në themelet e objektit të ri dhe atij ekzistues*
- d. *Konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.*

Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren

3.3.2 Preventivi përfundimtar

Konsulenti, në përputhje dhe në varësi të projektit të paraqitur duhet të paraqesë edhe preventivin përfundimtar përkatës.

Konsulenti duhet të paraqesë detyrimisht preventivin përfundimtar të punimeve. Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi.

Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale të bëhet analiza e çmimit bazuar në testimin e tregut duke marrë tre oferta nga operatorë ekonomike, që operojnë në vendin tonë (oferta që do të bëhen pjesë e dokumentit të dorëzuar).

3.3.3 Gjuha

Gjuha Shqipe do të jetë gjuha e përdorur në projekt dhe në relacionet apo raportet e ndryshme.

4. Raportimi

Të gjitha raportet duhet të dorëzohen në formë fizike dhe në formë elektronike.

Burimet e informacionit duhet të referohen dhe të përfshihen në një listë të plotë të të gjithë personelit dhe organizatave (duke përfshirë adresat dhe numrat e telefonit) me të cilin janë mbajtur takime dhe diskutime.

Vizatimet dhe raportet duhet të jenë në 4 (katër) kopje origjinale të printuara dhe 1 (një) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (auto cad, word, excel, etj.).

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari.

Të gjitha dokumentet e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë anëtarët e ekipit të projektimit.

DOKUMENTAT TË PROCEDURËS SHËRBIME KONSULENCE

Objekti “Hartimi i projektit arkitektonik dhe dokumentacionit perkates për Shtëpine Familje”

Projekti “Komuniteti i të ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës” AID 10950”, i bashkëfinancuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS), si dhe i implementuar nga Istituto Pace Sviluppo Innovazione ACLI

I NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1. Autoriteti Kontraktor

Emri Acli Ipsia në Shqipëri
Adresa Rruga "Palokë Kurti", Nr.1, Shkodër
Tel/Fax +355(0)68 4072096
E-mail acliscutari@gmail.com

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion i pavarur

X

2.2 Lloji i "Kontratave Publike për Shërbime"

Shërbime Konsulence

X

2.8 Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër

- Fondi limit 540 000 (peseqind e dyzet mije) leke pa tvsh .
- Burimi i Financimit: Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (AICS)
- Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Afati i realizimit të shërbimit do të jetë brenda 30 ditë kalendarike nga momenti i lidhjes së kontratës me objekt " "Hartimi i projektit dhe i dokumentacionit përkatës" për Shtëpinë Familje".
- Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:" Hartimi i projektit dhe i dokumentacionit përkatës" për Shtëpinë Familje".

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në ditë **30**

Procedura

Oferta duhet të dorëzohet në 2 zarfa të veçanta të nënshkruara dhe të nënshkruara. Dokumentet duhet të jenë në anglisht, përveç dokumenteve të lëshuara nga Autoritetet Shqiptare.

Zarfi i parë (i titulluar Dokumentet e para-kualifikimit) duhet të përfshijë dokumentet e para-kualifikimit si më poshtë:

1. CV e kompanisë (me provën e përvojës së kompanisë në kryerjen e punëve të ngjashme);
2. Kopja e regjistrimit dhe licencës së shoqërisë dhe personelit të tyre teknik;
3. Kopje e certifikatave ISO (ISO 9001 dhe 14001);
4. Kopjimi i statusit të tij me autoritetet tatimore dhe konfirmimi i Autoriteteve Tatimore për mungesën e detyrimeve për 6 muajt e fundit;
5. Bilanci i gjendjes për të vërtetuar qarkullimin për vitin e fundit duhet të jetë i barabartë ose më i madh se vlera e aplikuar; (autoritetet tatimore të nënshkruara, vulosur dhe protokollare)

Mungesa e një dokumenti të parakualifikimit do të rezultojë në skualifikim. Nëse aplikoni për të dyja pjesët, dokumentet e para-kualifikimit do të jenë të vlefshme për të dyja.

Zarfi i dytë (me titull Oferta teknike) duhet të përfshijë dokumentet e ofertës teknike të listuara më poshtë:

1. Oferta financiare bashkengjitur me projekt- idene dhe perzgjedhja e materialeve.

Procesi i vlerësimit do të bazohet në vlerë për para, oferta teknike do të vlerësohet me 70 pikë dhe oferta ekonomike do të vlerësohet me 30 pikë të ofertave të plota. Vlerësimi do të bëhet veçmas për secilën pjesë.

1. Kapaciteti, burimet, kompetencat dhe përvoja e tenderuesit të propozuar për kontratë: 20 pikë
2. Metodologjia e propozuar, qasja dhe plani i zbatimit: 30 pikë (të vlerësuara në bazë të pikës 1 dhe 2 të Ofertës Teknike)
3. Sistemi i Sigurimit të Cilësisë për ekzekutimin e Kontratës: 10 pikë (vlerësohet në bazë të pikës 4 të Ofertës Teknike)

4. Personi kryesor i propozuar: 10 pikë

5. Oferta ekonomike: 30 pikë

Oferta Ekonomike (në rënie në konkurrencën e çmimeve)

Metoda për llogaritjen e pikëve të vetme të secilës ofertë ekonomike:

Vlerësimi në lidhje me çdo ofertë të vetme ekonomike do të merret duke përdorur formulën e mëposhtme:

$P \text{ (Pikët)} = [\sqrt{P_{\min} / P_{\text{off}}}] \times 30$; do të thotë = rrënjë katrore e çmimit të ofertës minimale të ndarë nga oferta * 30

P_{\min} = çmimi minimal i ofertës

P_{off} = Çmimi i ofertës

Gjendja jonormale

Në analizën ekonomike të ofertës, para aplikimit të formulës së përshkruar më sipër, e cila përcakton pikën ekonomike, do të hidhen poshtë ofertat që do të jenë në rënie tepër të parregullt, sipas formulës së mëposhtme:

B_a = Çmimi i ankandit

O = Ofertë

MO = Mesatarja e ofertave të ofertave
n = numri i ofertave
Ra = pranohet poshtë

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / n$;
[Ba - MO] = Diferenca midis ofertës dhe ofertës së mediave;
Ra = [Ba-MO] + 1/5 x [Ba-MO];
[Ba - O] ≤ Ra

Diferenca midis çmimit të ankandit (Ba) dhe Ofertës së konsideruar (O) duhet të jetë më e vogël ose e barabartë me Ra.

Në rastin kur Oferta e konsideruar nuk plotëson verifikimin me formulën e ilustruar më lart, do të jetë anormale, do të konsiderohet anormalisht e ulët dhe më pas do të hidhet pa apel.

Për ofertën ekonomike mund të caktohet një maksimum prej 30 pikësh.

Më pas, çmimi i rezultatit total për konkurrentët individual do të jetë subjekt i mëposhtëm:

Rezultati total = Rezultati teknik (merita teknike) + Rezultati ekonomik (Propozimi i Biznesit).

Propozimet përfundimtare të kualifikuara shqyrtohen dhe vlerësohen sipas kriterëve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor. Ky i fundit ia jep kontratën atij Ofertuesi që ka paraqitur propozimin më të mirë të vlerësuar.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Kemi shqyrtuar Dokumentat e kesaj procedure dhe paraqesim këtë Propozim, pa rezervime ose përjashtime për kërkesat ose afatet dhe kushtet e shprehura këtu.
2. Ne ofrojmë të kryejmë Shërbimet siç specifikohet në Dokumentat e kesaj procedure dhe në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.
3. Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.
4. Propozimi ynë do të jetë i vlefshëm për periudhën e specifikuar në DT.
5. Nëse propozimi ynë pranohet, Ne do të bejme sigurimin e kontratës, siç parashikohet në DT.
6. Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë prokurim.
7. Ne autorizojme autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/dokumentet, që i bashkëlidhen kësaj oferte.
8. Pajtohem për të firmosur kontratën sipas kushteve të kontratës nëse shpalle fitues.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

DEKLARATË
Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim në gjuhën shqipe nga perkthyes zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht¹;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;
- b. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;
- c. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor),

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 10).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer xhiro mesatare vjetore per vitin 2017 në nje vlere prej jo më pak se vlere e fondit limit.

Ne plotesimin e kesaj pike operatori ekonomik duhet te paraqese:

- a. Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave për xhiron e realizuar gjatë viteve të sipërpërmendura.

2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2017.

3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një vertetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjise elektrike të kontratave te energjise që ka operatori ekonomik që eshte i rregjistruar ne Shqiperi.

Mosshlyerja e detyrimeve te energjise elektrike perben shkak per skualifikimin e operatorit ekonomik, pervec rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara te energjise elektrike, te konfirmuara ne vertetimin e leshuar nga furnizuesi, jane ne proces ankimimi ne Gjykate.

¹ Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

Furnizuesi i energjise elektrike eshte i detyruar qe ta leshoje kete vertetim jo me vone se 5 (pese) dite nga data e depozitimit te kerkeses se nga operatori ekonomik.

- 4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese një dokument që verteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore .

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% të vlerës së fondit limit , të realizuara gjatë tre viteve të fundit te aktivitetit të operatorit.

Për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:

- a. Kur kontratat janë të realizuara me ente publike , ofertuesi duhet të paraqesë kontratën e lidhur me Institucionin të shoqëruar me vertetimet nga institucioni me të cilin janë nënshkruar këto kontrata mbi realizimin me sukses te tyre, ku të shënohet data, vlera, dhe shërbimet e realizuara.
- b. Kur kontratat jane te realizuara me subjekte private ofertuesi duhet të paraqese faturat tatimore te shitjes (ku të shprehen qartë datat, shumat, dhe shërbimet e realizuara).

2 Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për studim/projektim (leshuar nga MZHUT/MEI) ku të përfshihen kategorite:

2.1) Ose Operatori ekonomik duhet te paraqese **Licencen profesionale te shoqërise** për projektim ne kategoritë si më poshtë (sipas modelit te miratuar me Vendim Të Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016):

1. PROJEKTUES URBANIST

- a- 1.Plane kombëtare sektoriale;
- b- 2.Plane të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare.
- c- 1.Plane sektoriale në nivel qarku;
- d- 2.Plane sektoriale në nivel bashkie.
- e- Plane të detajuara vendore.

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- a- Projektim arkitekturor për objekte banimi–objekte industriale–objekte turistike.
- b- 1.Objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara;
- c- 2.Qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore;
- d- 3.Objekte spitalore; терминалет në infrastructure; vepra arti në infrastrukturë.
- e- Projektim interiere.
- f- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a- Objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet betonarme deri në 5 kate.
 - b- 1.Objekte civile-industriale-turistike mbi 5 kate.
 - c- 2.Objekte me skelet metalik.
 - d- 1.Projektim troje dhe shpate me cilesi te ulet.
 - e- 2.Projektim objekte civile e turistike prej druri.
4. PROJEKTUES INSTALATOR
- a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
 - b- Projektim të instalimeve termo teknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
 - c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
 - f- Projektim i sistemeve kundra zjarrit.
 - i- Projektim i ndricimit rrugor shesheve dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroportive.
5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE
- b- Projektim furnizim me ujë-kolektorë shkarkimi.
 - c- Projektim ujësjellës kanalizime urbane - rurale.
 - e- Projektim vepra të trajtimit të ujit.
6. PROJEKTUES GJEODET
- a- Rivelime inxhinierike.
 - b- Rilevime inxhinierike kadastrale
 - d- Bazamente gjeodezike
 - e- Projektim fotogrametrik dhe hartografik
7. STUDIM GJEOLLOGO INXHINIERIK - HIDROGJEOLLOJIK
- a- Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate.
 - d- Studim/Vlerësim gjeollogo inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
 - e- Studime e projekte hidrogjeologjike.
8. PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
- d- Projektim nën stacione elektrike, primar sekondar-linja të tensionit të lartë.
 - e- Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës-linja të tensionit të ulët-të mesëm.
9. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.
- a- Sinjalistikë jo ndriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.
 - b- Sinjalistikë jondriçuese në autostrada, rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore dhe në degëzime me hekurudhën.
 - d- Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet te ekuivalentoje (njesoje), licensen profesionale qe disponon, te leshuar nga vendi i origjines, prane Ministrise se Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

3. Operatori ekonomik duhet te paraqese **licencat** qe do te perfshije për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar, shoqeruar patjeter me **Diplome, CV.**

- 1 (nje) inxhinier infrastrukture/ndërtimi/rruga ura
- 1 (nje) nje akrkitekt/urbanist
- 1 (nje) inxhinier mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) inxhinier elektrik/elektroteknik
- 1 (nje) inxhinier gjeodet (makshejder)
- 1 (nje) inxhinier mjedisi/ kimist teknolog
- 1 (nje) inxhinier gjeolog

3.1 Deshmi per stafin punonjes te operatorit ekonomik, ku numri mesatar i punonjesve te siguruar te jete jo me i vogel se 3 (tre) punonjes per periudhen viti 2017 dhe Janar – Mars 2018

Për këtë duhet të paraqesë:

- **Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore**, Shendetesore dhe Tatimit mbi te ardhurat nga Punesimi, (Formularet E-Sig 025/a.1) per periudhen viti 2017 dhe Janar – Mars 2018, te konfirmuara nga drejtoria e tatimeve, shoqeruar dhe me **urdherpagesat.**

- 3 Operatori ekonomik duhet të jete i paisur me keto çertifikata ne perputhje me objektin e prokurimit:
- Çertifikate per sistemin e menaxhimit te cilesise **ISO 9001:2008 (e vlefshme)**
 - Certifikate per sistemin e menaxhimit te mjedisit **ISO 14001-2004 (e vlefshme).**
 - Çertifikate per sistemin e menaxhimit Shendetesor dhe te Sigurise ne pune **BS OHSAS 18001:2007 (e vlefshme).**

Per sherbimet e projektimit ofertuesi të ketë në pronësi ose me qira

a- [GPS](#)

Per kete OE te paraqese:

- kontrata shitblerje ose kontratë qiraje të noterizuar si dhe dokumentat e pronësisë së qiradhënësit (origjinal ose kopje e noterizuar).

3. Ofertuesi duhet të ketë pjese të stafit **ekspert per hartimin e raporteve te ndikimit ne mjedis dhe auditim mjedior.**

- 4 *Operatorët ekonomikë ofertues që kanë patur marrëdhënie kontraktuale të mëparshme me autoritetin kontraktor dhe të cilët kanë rezultuar me mospermbushje të suksesshme të objektit dhe detyrimeve perkatëse të kontratës, do të skualifikohen.*
- 5 *Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në tender.*

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Shërbimet e Konsulencës

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mbron në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mbron në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.

- 4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurt.

- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Specifikime dhe Skicime

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjësore përpara i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 10 Lejet dhe Liçensat

- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në ofertën e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.

11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

Neni 12 Vendndodhja

12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.

12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 14 Çmimi i Kontratës

14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 15 Afatet e Pagesës

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës

Në rast të verifikimit të vonesave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithëse kontraktuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare

Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

Nëse pas datës së dorëzimit të ofertave ose datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj ose akt nënligjor në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 18 Forca Madhore

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

- 19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuiojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkaku dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:
- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 22 Ndryshimi i Porosisë

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim

23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26 Nënkontrata

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

- 26.3 Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të japë me nensipermarrje.
- 26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

Neni 27 Transferimi i të Drejtave

- 31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 28 Sigurimi i Kontrates

- 28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar
- 28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 29 Baza Ligjore

- 29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 31 Përfaqësimi i Palëve

- 31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

- 31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32 Lajmërimet

- 32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 33 Llogaritja e Afateve

- 33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.



KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES

Shërbimet e Konsulencës

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës

Neni 1 Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është _____

1.2 Kontraktuesi është _____

Neni 2 Sigurimi i kontrates

2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej (10 % te vleres se kontrates) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:

Neni 3 Fillimi i Kontrates

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të fillojë më _____. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve

4.1 Shërbimet do të kryhen në: _____

Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: _____

Neni 6 Kërkesat e Raportimit



6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: _____

Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon: _____

Neni 8 Kushtet e Pagesës

8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: _____

8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _____ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.3 Monedha e pagesës do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 9 Pagesa Paraprake

9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit të kontratës.

9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: _____
